

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) i Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), si dhe në bazë të njoftimit për përqendrim i parashtruar nga MAN-ENERXHI SOLUSHNS SE (MAN Energy Solutions SE) me seli të regjistruar në Shtadbahshtrase 1, 86153 Augsburg, Gjermani, i dorëzuar përmes avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 10.03.2021, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin MAN-ENERXHI SOLUSHNS SE (MAN Energy Solutions SE) me seli të regjistruar në Shtadbahshtrase 1, 86153 Augsburg, Gjermani fiton kontroll mbi X-TEK Sistem GmbH (H-TEC Systems GmbH) me seli të regjistruar në Am Mitleren Mos 46, 86167 Augsburg, Gjermani, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës thelbësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në pajtim me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet të paguaj taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6 000,00 den. si dhe për Vendimin në shumën prej 30.000,00 den, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 и 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840.....03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në pajtim me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 22.12.2020, plotësuar më 30.12.2020 dhe 19.02.2021, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim për përqendrim nga MAN-ENERXHI SOLUSHNS SE (MAN Energy Solutions SE) me seli të regjistruar në Shtadbahshtrase 1, 86153 Augsburg, Gjermani fiton kontroll mbi X-TEK Sistem GmbH (H-TEC Systems GmbH) me seli të regjistruar në Am Mitleren Mos 46, 86167 Augsburg, Gjermani.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazë të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si në vijim:

MAN ES është një shoqëri e varur indirekte e Folksvagen Akciengesellschaft ((Volkswagen Aktiengesellschaft; „VWAG“) shoqëri, aksionet e së cilës tregtohen publikisht dhe me seli në Wolfsburg, Gjermani, e cila është shoqëri udhëheqëse e Grupit Folksvagen (Volkswagen Group; „VW Group“).

VW Group është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjet e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve(coashes), ,shasi për autobusë dhe motorë me naftë, motoçikleta, përfshirë pjesë rezervë dhe pajisje shtesë për të gjitha kategoritë e theksuara të automjeteve. VW Group është gjithashtu e angazhuar në shpërndarje të automjeteve.

VW Group përfshin markat e automjeteve Volkswagen Passenger Cars, Volkswagen LightCommercial, Porsche, Audi, Škoda, Bentley, Bugatti, Lamborghini, SEAT, MAN, Scania и Ducati. Kohën e fundit, VW Group ka vendosur markn MOIA, që është aktive në zhvillimin dhe marketingun e shërbimeve të lëvizjes, si p.sh. thirrje e makinës (ride hailing) dhe ndarje e makinës (car sharing). Aktivitetet e Grupit VW gjithashtu përfshijnë shërbime të lidhura të makinave (connected car services), mbështetje për ndarjen e makinave(car sharing support) dhe shërbimet e flotës/ parku i makinave (fleet services). Në mënyrë plotësuese, VW Group ofron shërbime financiare dhe të sigurimeve lidhur me shpërndarjen dhe financimin e makinave të saj dhe automjeteve komerciale. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes Folksvagen Fajnenshll Servisis AG (Volkswagen Financial Services AG ("FSAG")) dhe shoqëritë e sajë të varura. FSAG ofron shërbime individuale mobile siç janë financimi, lizingu, sigurimi dhe shërbimet për blerjen e sigurimeve në lidhje me makinat dhe automjetet komercialë. Përfundimisht, përmes shoqërisë së varur FSAG- Folksvagen Bank GmbH (Volkswagen Bank GmbH), VW Group ofron shërbime të drejtpërdrejta bankare.

MAN ES u themelua në vitin 2010 pas bashkimit të MAN Diesel dhe MAN Turbo. Ajo operon 120 reparte në të gjithë botën dhe është një nga prodhimet më të mëdha në botë të motorëve me naftë dhe benzinë me një hapje të madhe (large-bore) dhe turbo-makinave. Portofoli përfshin motorë me dy dhe katër goditje për përdorim në det dhe në pushim, turbo-karikues dhe propeler, siç janë turbina me gaz dhe avull, kompresorë dhe reaktorë kimikë.

Grupi Folksvagen ka shoqëritë e varura të regjistruara në vijim në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

1. Shoqëria e lizingut PORSHE LIZING SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Bosnje dhe Hercegovinë nr. 3 Shkup, veprimtaria të regjistruar - lizing financiar
2. Shoqëria aksionare për kryerjen e veprimtarive të brokerimit të sigurimeve PORSHE BROKER SHA Shkup, me seli të regjistruar në Bul. Bosnjë dhe Hercegovinë nr. 3 Shkup, me aktivitet të regjistruar - aktivitete të agjentëve të sigurimeve dhe ndërmjetësve të sigurimeve;
3. Shoqëria për tregti dhe shërbime SKANIA MAKEDONIA SHPKNJP import-eksport Ilinden, me seli të regjistruar në rrugën 34 nr.7, Ilinden, Shkup, dhe me aktivitet të regjistruar - tregti me automjete të tjera motorike; dhe
4. Shoqëria për tregti dhe shërbime PORSHE MACEDONIA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. Bosnjë dhe Hercegovin[nr. 4, Shkup, me aktivitet të regjistruar-tregti me makina dhe automjete motorike të kategorisë së lehtë.

H-TEC është shoqëri e fokusuar në kërkimin dhe zhvillimin e teknologjisë lidhur me hidrogjenin. Në repartet e prodhimit në Shlezvig- Holshtajn dhe Bavari, Gjermani, H-TEC prodhon montime komplekse dhe elektrolizatorë në klasën megavat (stacks and electrolyzers in the megawatt class) dhe përqendrohet në procesin e membranës së shkëmbimit të protoneve (PAM) për aplikimin industrial të hidrogjenit dhe shndërrimin e energjisë elektrike për prodhimin e të ashtuquajturës. hidrogjen i gjelbër. Produktet e tij PAM potencialisht mund të përdoren në një numër të madh situatash në fushën e transportit, kërkimit dhe zhvillimit, përdorimin e materialit, power-to- X (shndërrimin dhe ruajtjen e energjisë elektrike) dhe furnizimin me energjinë e nxehtësisë.

H-TEC nuk ka shoqëri të regjistruara në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut në vitin paraprak.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të përcaktojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës genësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritje të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Vladimir Naumovski